

PROCESVERBAL
nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele
e mbajtur më 31.03.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet konferencës me video lidhje: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kraetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët që mungojnë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes në videokonferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 13-të të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video konferencë.

Këshilli i Agjencisë, miratoi njëzëri si në vijim:

RENDI I DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, e mbajtur më 28.03.2022.
2. Propozim-vendim për ribalans të Planit financiar të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2022.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shikoj dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, e mbajtur më 28.03.2022, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim-vendimin për ribalans të Planit financiar të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2022. Shpjegoi se kjo pikë që ishte lajmëruar në seancën e kaluar ka të bëjë me furnizimin publik për përgatitjen e një Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për TV transmetim në nivel shtetëror e cila dy herë nuk pati sukses për shkak se çmimin që e ofruan operatorët ishte shumë më i lartë nga ajo që ishte e paraparë në Planin financiar të ASHMA-së për vitin 2022. Për atë shkak i propozohet Këshillit që të rrisë mjetet kështu që në Planin

finansiar për vitin 2022, totali i shpenzimeve të planifikuara të mbeten në nivelin e përcaktuar. Mjetet rriten nga furnizime të tjera publike – Shërbime revizive. Vuri në dukje se për informata të detajuara pikërisht nga cilat artikuj do të sigurohen mjetet shpjegim do të japë udhëheqësi i Sektorit për finansa dhe logjistik Goran Radunoviq.

Udhëheqësi Radunoviq shpjegoi se bëhet fjalë për rritjen e shkallës nga 102.000,00 denarë, të destinuara për rritjen e mjeteve për përgatitjen e një Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpalljen të konkursit publik për dhënien e lejes për TV transmetim në nivel shtetëror. Me ribalancin e propozuar do të bëhet ndryshim grupor i shkallës 418 – Shpenzimet e tjera të mbetura do të zvogëlohen për 102.000,00 denarë dhe pozicioni 418800 – Shpenzime të tjera të cilat gjithashtu do të zvogëlohen për 102.000,00 denarë. Kjo do të rrisë shkallën grupore 417 – Shërbime të tjera dhe intelektuale për 102.000,00 denarë dhe Pozicionin 417800 – Shërbime të tjera të papërmendura –për shumën identike. Me këto mjete do të sigurohen 510.000,00 denarë pa TVSH ose në total 602.000,00 denarë me TVSH që të mund të realizohet furnizimi. Vuri në dukje se si shtesë të materialit sipas pikës është dorëzuar dhe propozim- vendim me të njëjtat ndryshime që i ka arsyetuar dhe Propozim – plani financiar në të cilin janë bërë ndryshime grupore të shkallës dhe pozicioneve që ai prezantoi.

Z.Petrushevski tha se në pajtim me materialin dhe arsytimet është mjaft e qartë se për çfarë bëhet fjalë, nuk ka vërejtje apo pyetje dhe hapi diskutim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri solli Vendim që miraton ribalansin e Planit financiar të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2022, nr.05-591/1 nga 10.02.2022.

Me ribalansin e propozuar të Planit financiar për vitin 2022, shpenzime totale të planifikuara mbeten në nivelin e përcaktuar, përkatësisht arrijnë në 133.754.238,00 denarë.

Me ndryshimet e propozuara, do të sigurohen mjete financiare në shumë totale nga 102.000,00 denarë, të destinuara për rritjen e mjeteve për përgatitjen e studimeve për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për TV transmetim në nivel shtetëror.

Me ribalansin e propozuar do të bëhen ndryshime në pozicionet e mëposhtme:

- Shkalla grupore 418 – Shpenzimet e tjera zvogëlohen për 102.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale nga 5.378.000,00 denarë është 5.276.000,00 denarë dhe
- Pozicioni 418800 – Shpenzime të tjera zvogëlohen për 102.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale nga 5.378.000,00 denarë është 5.276.000,00 denarë. Po punohet për zvogëlimin e mjeteve që ishin planifikuar për zbatimin e furnizimit publik të shërbimit – shërbime revizioni për nevojat e Agjencisë dhe për paraqitjen e furnizimit publik është lidhur një kontratë në shumë më të ulët se sa ishte planifikuar.
- Shkalla grupore 417 – Shërbime të tjera dhe intelektuale rriten për 102.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale nga 17.252.000,00 denarë është 17.354.000,00 denarë dhe
- Pozicioni 417800 – Shërbime të tjera të papërmendura - hulumtime rriten për 102.000,00 denarë dhe në vend të shumës aktuale nga 4.630.000,00 denarë është 4.732.000,00 denarë. Mjete shtesë që sigurohen nga 102.000,00 denarë, i referohen përgatitjes së një studimi për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për TV transmetim në nivel shtetëror.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm duhet ta shpallë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-1410/3

04.04.2022

Sh k u p

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v